



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivary	09 - 10 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHICK 6470/2023			117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1134/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi--anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1134/2023 të datës 01.09.2023 të parashtruar nga ankuesit

kundër Ministrisë së Ekonomisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar nga se është e parakohshme ankesa me numër A.nr.1134/2022 e datës 01.09.2023 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Më datë 31.03.2023 është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, ku në bazë të kësaj rregulloreje ka pasur ndryshime për pozitat përkatëse. Më datë 06.07.2023 sipas Vendimit V.nr.06/KR/2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Në bazë të këtij vendim ky komision është i obliguar të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga



Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë(që ishte në fuqi në këtë kohë) dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë. Sipas Vendimit me Nr. Ref. 1215/1/2023 të datës 07.08.2023 Komisioni i Ristrukturimit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ka bërë zgjatjen e afatit të punës së komisionit për tridhjetë (30) ditë të tjera.

Ankuesit të gjithë nëpunës civil të punësuar në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, më datë 01.09.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 5914/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Më datë 06.09.2023 Komisioni i Ristrukturimit ka nxjerr Raportin Përfundimtar lidhur me ristrukturimin e pozitave të nivelit të Departamentit, nivelit të Divizionit dhe nivelit Profesional.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 08.09.2023 ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Ekonomisë. Këshilli, me datë 13.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Ekonomisë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 5914/2023 e datës 01.09.2023 dhe Parashtresën me numër protokolli 1134/2023 të datës 06.09.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 13/52 të datës 29.12.2021; Shkresën e datës 20.04.2023, 24.04.2023 nga ankuesit; Vendimin me Nr Port: 591 të datës 22.08.2023 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Emailin e datës 28.08.2023 nga E.Q për L.M; Emailin e datës 30.03.2023 nga Z.K për L.M dhe B.B; Emailin e datës 28.08.2023 nga L.M për E.Q; Emailin e datës 28.08.2023 nga E.Q për Z.K; Njoftimin për Ministren e Ekonomisë i datës 06.09.2023 nga ankuesit; Reagim ndaj emërtimeve selektive në pozita të caktuara në laborator të SHGJK-së nga ankuesit e datës 06.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 13.09.2023; Akt Emërimit e datës 01.01.2016 të ankuesit B.S; Formularin për përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Sedimentologji dhe Paleontologji i datës 11.05.2023; Akt Emërimit e datës 01.04.2016 për ankuesin E.Q; Formularin për përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Gjeokimi i datës 11.05.2023; Akt Emërimit e datës 01.12.2016 për ankuesin F.B; Formularin për përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Gjeologji Inxhinierike i datës 11.05.2023; Akt Emërimit e datës 01.01.2016 për ankuesin Sh.M; Formularin për përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar për Gjeodatabazën e të dhënave, Arkivit dhe hartografim; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 01.01.2016 për ankuesën D.S; Vendimin me Nr. Prt: 383 të datës 25.02.2022; Listën e pozitave sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës; Vendimin V.nr.06/KR/2023 i datës 06.07.2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin Nr.Ref.1215/1/2023 të datës 07.08.2023 për zgjatjen e afatit të punës së Komisionit të Ristrukturimit; Lista e titujve dhe përshkrimet pozitive të punës



në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës e datës 30.08.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë për Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Raporti Përfundimtar i Komisionit të Ristrukturimit me numër reference KR/SHGJK 09/2023 i datës 06.09.2023; Formulari i përshkrimit të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Sedimentologji, Zyrtar i Lartë për Gjeokimi, Zyrtar i Lartë për Gjeologji Inxhinierike, Zyrtar për GIS, Hartografi dhe Bazës së të Dhënave, Zyrtar i Arkivit, Bibliotekës dhe Redaktimit, Zyrtar për Analiza Gjeolo Inxhinierike, Zyrtar i Lartë për Vendburime Minerale; Shkresë me titull Vendosja e pozitave të zyrtarëve nga pozita aktuale në pozitën e re e datës 04.09.2023; Emailin e datës 05.09.2023 nga I.Sh për F.K; Emailin e datës 04.09.2023 nga ankuesja D.S për I.Sh; Emailin e datës 11.09.2023 nga I.Sh për F.K; Emailin e datës 04.09.2023 nga ankuesja Sh.M për I.Sh; Emailin e datës 07.07.2023 NGA Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ME për nëpunësit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Shërbimit Gjeologjik të Kosovës; Emailin e datës 25.07.2023 nga L.M për M.O.Sh; Emailin e datës 20.07.2023 nga M.O.Sh për L.M; Emailin e datës 19.07.2023 nga L.M për I.Sh, A.Ç, F.S, Sh.M; Emailin e datës 18.07.2023 nga F.K për L.M; Emailin e datës 17.07.2023 nga L.Z për A.M.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e palejuar nga se është e parakohshme, **SEPSE:**

Ankuesit përmes ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkojnë që të shfuqizohet Rregullorja (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ose plotësim/ndryshimin e kësaj rregulloreje, me arsyetimin se kjo rregullore është përgatitur vetëm nga një person zv. Drejtori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, duke pretenduar se kjo rregullore është përgatitur nga një mos transparencë ndaj nëpunësve civil; Ka pasur shkelje në ndryshimet e pozitave sipas kësaj rregulloreje.

Lidhur me pretendimin e palëve ankuese që të shfuqizohet Rregullorja (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ose të bëhet plotësim/ndryshimi i kësaj rregulloreje, Kolegji i Këshillit, ju referua Aktgjykimit në rastin nr. KI10/22 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ.nr.115/2021 të datës 18.11.2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës e që ndërlihet me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD-Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Aktgjykimit në rastin nr. KI10/22 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, respektivisht me nenin 75 të tij, thuhet se: "...në këndvështrimin e Gjykatës konstatohet se ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe



akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës se përcaktuar me Kushtetutë, në nenin 77 theksohet se: "Në anën tjetër, Gjykata në bazë të nenit 113.7 e ve në funksion juridiksionin e saj rishikues dhe subsidiar për të gjitha kërkesat individuale mbi respektimin e të drejtave kushtetuese, të cilat kanë si objekt kontesti edhe aktet nënligjore normative. Juridiksioni rishikues si i tillë aktivizohet pas shterimit të mjeteve juridike. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, kufiri ku fillon dhe ku mbaron juridiksioni i kontrollit gjyqësor ndaj akteve nënligjore normative dhe ku fillon juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese është i mirëpërcaktuar kur bëhet fjalë për ushtrimin e juridiksionit subsidiar (rishikues) të Gjykatës. Në këtë drejtim, pasi që parashtruesit e kërkesës të kenë marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat e rregullta, mbi bazën e padisë së tyre mbi kontestin e tyre ndaj ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ, atëherë ata legjitimohen që pretendimet për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore t'i artikulojnë në ankimin individual kushtetues, me nenin 79 është përcaktuar se: "Rrjedhimisht, Gjykata në vijim e vë theksin edhe tek studimi i Komisionit të Venedikut i cili vlerëson se në lidhje me llojet e normave që mund të paraqiten për vlerësim kushtetues, gjykata kushtetuese duhet të jete e ngarkuar vetëm me verifikimin e kushtetutshmërisë së akteve ligjore, duke ua lënë në parim kontrollin e akteve nënligjore gjykatave të zakonshme, në mënyrë që të shmangin mbingarkimin e 18 saj. (shih studimin nr. 538/2009 [CDL-AD(2010)039rev.] mbi qasjen individuale në gjyqësinë kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e 85-te (17-18 dhjetor 2010), paragrafi 6)", me nenin 80 është përcaktuar se: "Prandaj, bazuar nga si me sipër, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-se me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtruesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e "qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-se; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtruesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës". Si përfundim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, sipas këtij aktgjykimi, sipas nenit 88 thuhet se: "Gjykata, pas elaborimit dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar dhe arsytimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, konstatoi se: (i) ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë; dhe (ii) gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-se me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtruesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e "qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-se; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtruesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës. Ndërsa sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi respektivisht sipas pikës III është vendosur: **TË SHPALLË** të pavlefshëm, Aktgjykimin [AR].nr. 115/2021 të 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimin [AA.nr.651/2021] e 6 gushtit 2021, të Gjykatës së Apelit, si dhe Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe sipas pikës IV. **TË KTHEJË**, për rishqyrtim Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykatë.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është institucion i cili ka për qëllim sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, rrjedhimisht



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është institucion kompetent të bëjë mbikëqyrjen nëse aktet nënligjore janë në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme dhe mënyrën e miratimit të tyre, kështu që ankuesit lidhur me këtë pretendim mund të drejtohen në gjykatat e rregullta.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve ka pasur shkelje në ndryshimet e pozitive sipas kësaj rregulloreje, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi B.S sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit Emërimit të datës 01.01.2016 ka mbajtur pozitën *"Zyrtar i Lartë për Sedimentologji dhe Paleontologji"*, ndërsa sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës kjo pozitë është ndarë në dy pozita respektivisht *"Zyrtar i Lartë për Sedimentologji dhe Zyrtar i lartë për Paleontologji"*, ankuesi E.Q, sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2016 ka mbajtur pozitën *"Zyrtar i Lartë për Gjeokimi"* ndërsa sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës kjo pozitë nuk ka pasur ndryshim në emërtim, ankuesi F.B sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.12.2016 ka mbajtur pozitën *"Zyrtar i Lartë për Gjeologji"*, sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ka pësuar ndryshime duke ju shtuar prapashtesa *"Inxhinierike"*, ankuesja Sh.M, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.01.2016 ka mbajtur pozitën *"Zyrtar për Gjeodatabazën e të dhënave, Arkivit dhe Hartografin"*, ndërsa sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës kjo pozitë ka pësuar ndryshime duke u paraparë si pozitë *"Zyrtar për GIS, Hrtografi dhe Bazë të të Dhënave"*, ankuesja D.S sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.01.2016 ka mbajtur pozitën *"Zyrtar për Arkiv, Bibliotekë dhe Redaktim"* e cila sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës është paraparë si pozitë, ankuesi N.B ka mbajtur pozitë *"Zyrtar i Lartë për Vendburime Minerlae"* ndërsa kjo pozitë është paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, bazuar në këtë përveç pozitës së ankuesit B.S, F.B, Sh.M dhe D.S pozitat e ankuesve të tjerë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës nuk janë shuar apo ndryshuar.

Marr për bazë Raportin Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit me numër reference KR/SHGJK 09/2023 të datës 06.09.2023, konstatohet fakti se ankuesi B.S është propozuar të sistemohet në pozitën *"Zyrtar i Lartë për Sedimentilogji"*, ankuesja F.B është propozuar të sistemohet në pozitën *"Zyrtar i Lartë për Gjeologji Inxhinierike"*, ankuesja Sh.M është propozuar të sistemohet ne pozitën *"Zyrtar për GIS, Hartografi dhe Bazës së të Dhënave"*, ankuesja D.S është propozuar të sistemohet në pozitën *"Zyrtar për Analiza Gjeolo Inxhinierike"*.



Sa i përket çështjes së ristrukturimit respektivisht transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, Kolegji i Këshillit, i' u referuar Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë(i aplikuar në këtë periudhë), përkatësisht:

Neni 54 paragrafi 3, i cili përcakton se: "Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit.

Po ashtu Kolegji i Këshillit i' u referuar Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, përkatësisht: nenit 14 paragrafi 1, i cili përcakton se: "Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse brenda 15 dite të aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori", nenit, 15 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, ku parashihet se: "1. Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dijetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit. 2. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, në rastet e përcaktuara me Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 3. Njësia përgjegjëse verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të shfuqizoj vendimin nëse plotësohen kushtet e përcaktuara me Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 4. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të përcaktuara me Neni 52. paragrafin 3 të Ligjit përmben shkak për lirin nga shërbimi civil", nenit 17, i cili përcakton se: "Në rast të pakënaqësive ndaj vendimeve për transferet sipas kësaj Rregulloreje, nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative".

Andaj, Kolegji i Këshillit duke marr parasysh këtë fakt, konstaton se ankuesit ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e kanë parashtruar para nxjerrjes së Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit me numër reference KR/SHGJK 09/2023 të datës 06.09.2023, po ashtu edhe në parashtresën e datës 06.09.2023 nuk kanë ndonjë pretendim për propozimet që janë bërë nga Komisioni i Ristrukturimit mirëpo pretendimet janë më shumë në kuadër të hapave procedural të përgatitjes dhe miratimit të Rregullores (ZKM) Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, si rezultat i kësaj ankuesit që i janë ndryshuar pozitat sipas kësaj rregulloreje nuk kanë pritur afatin procedural të transferimit nga Njësia përgjegjëse sipas propozimeve të bëra përmes Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit me numër reference KR/SHGJK 09/2023 të datës 06.09.2023.

Bazuar nga ajo që u tha si më lartë e në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i' u referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 124 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: "1. Pala





ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprini apo mosveprini administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim”, nenit 125 paragrafi 1, me të cilin është përcaktuar se: “Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)", Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se nuk është nxjerrë ndonjë akt administrativ lidhur me sistemimin e ankuesve për shkak të ristrukturimit sipas dispozitave të cekura më lartë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të aplikuar në këtë kohë dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se në këtë fazë të procesit ankesa e ankuesve është e parakohshme.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1134/2023, datë 09/10/2023

**AvdyL BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve;
- Drejtorit Ekzekutiv të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së